



Tiranë, më 17.07.2020

RREGULLORE

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT
TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN “EDUKIM FIZIK DHE SPORTE”
NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR NË
UNIVERSITETIN “BARLETI”
PËR VITIN AKADEMIK 2020- 2021**

(MESHKUJ – FEMRA)

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII "Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë" përkatësisht në nenin 74 dhe në Rregulloren e Universitetit "Barleti" të ciklit të parë të studimeve Bachelor, konkursi i pranimit në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" për vitin akademik 2020-2021 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

1. Pranimi i kandidatëve për studentë në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" në Universitetin "Barleti" bëhet me konkurs. Pranë Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve zhvillohet konkursi i pranimit mbi bazë të rregullave të shprehura në këtë Rregullore, të kriterëve të pranimit të miratuara nga Universiteti "Barleti", të mesatares së shkollës së mesme përcaktuar me VKM dhe të testit fizik që përbëjnë rezultatin përfundimtar të konkursit.

Neni 2

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

1. Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
2. Në përbërje të Komisionit të Pranimit aktivizohen: Titullarë të fushës së edukimit fizik e sporteve dhe pedagogë efektivë të Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve.
3. Në përbërje të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë, të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit, apo janë në konflikt interesi.
4. Në mjediset ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga titullari i Universitetit "Barleti".

Neni 3

Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurimit.

1. Konkursi për pranimin e studentëve në ciklin e parë Bachelor në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" për UB do të zhvillohet në mjediset e Kampusit Nr. 2, Selitë (Salla Sportive).



- Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës zyrtare të shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokumentat, si më poshtë:
 - Kartë identiteti/Pasaportë.
 - Raportin mjeko-ligjor të nënshkruar dhe vulosur nga Mjeku i autorizuar nga UB, sipas analizave përkatëse (Kartela individuale shëndetësore e kandidatit, poshtëshënuar).
- Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.**
- Komisioni do të punojë paradite, duke i bërë të njohura më parë oraret. Data dhe Orari i fillimit të konkurimit do të shpallen në faqen zyrtare të internetit të UB ëëë.umb.edu.al, si dhe në mjediset e të dy kampuseve, të paktën një javë përpara fillimit të konkursit.
- Ditën e parë të konkursit, pasi kandidatët janë sistemuar në mjediset e zhvillimit të tij, Kryetari i Komisionit i komunikohen rregullat e konkurimit.
- Sekretaria mësimore i dorëzon me procesverbal Kryetarit të Komisionit të Konkurimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të ardhura zyrtarisht nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe MASR.
- Bazuar në kriteret e konkursit, Komisioni krijon hapësirën kohore të nevojshme për konkurimin individual të kandidatëve gjatë konkursit.

Neni 4

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit.
- Numri i anëtarëve të komisionit është 3 (tre).
- Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e komisionit mbajnë shënimet përkatëse.
- Pas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të të gjitha seancave të konkurimit Komisioni i Pranimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhet për të vlerësuar paraqitjet e secilit kandidat.
- Komisioni i Pranimit të Programit të studimit Edukim Fizik e Sporte, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të rezultateve të konkurimit, e cila në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- Lista e nënshkruar, si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurent, i dorëzohen me procesverbal Përgjegjësit të Departamentit.
- Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë konkuresit firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit.

Neni 5

Shpallja e fituesve

- Shpallja e fituesve bëhet duke u bazuar në Udhëzimin e MASR për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe në vendimin e Senatit të UMB-së për kriteret e pranimit në programet e studimit të Universitetit “Barleti”.

Neni 6

Rregulla për kandidatët

- Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:
 - Kandidati duhet të paraqitet në UB në ditët dhe orët e përcaktuara në kalendarin e zhvillimit të konkurseve të shpallur zyrtarisht.
 - Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Konkursit në bazë të orarit të përcaktuar.
 - Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në skualifikimin e tij nga konkursi.



- d) Nëse ka kandidatë që konkurojnë në dy ose më shumë programe studimi dhe konkursi zhvillohet në të njëjtën kohë, atëherë kandidati paraqet një kërkesë me shkrim te Dekani i Fakultetit për t'i mundësuar paraqitjen në të gjitha konkurimet.
- e) Testi kryhet vetëm një herë. Nëse ndërpritet qëllimisht apo kryhen gjeste antisportive, nuk mund të rifillohet rishtas.
- f) Kandidati mund të largohet nga konkurimi, kur komisioni do t'ia kërkojë këtë gjë.
- g) Për problematika të veçanta gjatë procesit të konkurimit, komisioni ka të drejtën e vendimmarrjes.

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK E SPORTEVE